



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 283, Datë 18.12.2024

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “MOUNTAIN’S GREEN ENERGY” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a” 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2346/6prot., datë 17.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “MOUNTAIN’S GREEN ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2346 prot., datë 05.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau Dejës, Qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 1 975 kW.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 248, datë 18.11.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.11.2024 dhe 20.11.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 02.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Gjithashtu, me shkresën nr. 2346/4 prot., datë 02.12.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar gjithashtu që të bëjë me dije ERE-n në rast se nga ana e MIE-s ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratave të depozituara në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues, në lidhje me këtë shkresë MIE nuk ka kthyer përgjigjeje.

- Me shkresën nr. 2346/3 prot., datë 25.11.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës, ku është evidentuar dhe informacioni/dokumentacioni i plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.
- Në vijim shoqëria me shkresën nr. 2346/5 prot., datë 05.12.2024, ka depozituar në ERE informacion plotësues për aplikimin.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k.:
 - Ka marrë miratimin për transferimin e të drejtës për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë fotovoltaike me kapacitet prodhues 1975 kW, në zonën Gomsiqe, Vau i Dejës, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Miratimin Përfundimtar nr. 400913 prot., datë 04.10.2017 dhe kontratave të nënshkruara me MIE-n, nga shoqëria “IN FOOD” sh.p.k. tek shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., me shkresën e MIE-snr. 3222/2 prot., datë 26.07.2021,
 - Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaike me adresë në Gomsiqe, Vau i Dejës, me kapacitet 1975 kW, nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a. 7247/3 prot., datë 03.08.2024;
 - Ka depozituar VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në datën 07.09.2017, për Personin Juridik “IN FOOD” sh.p.k. për të zhvilluar projektin: “Central diellor fotovoltaike”, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër.
- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9112 rep., nr., 3449 kol., datë 29.12.2017, e ndryshuar, përcaktohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka plotësuar jetëgjatësinë e pritshme për 30 vjet, ka depozituar dhe garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike dhe në planin e biznesit të saj rezulton se jetëgjatësia ekonomike e centralit do të jetë 30 vjet, ndaj në këto rrethana, dhe afati i licencës do të jetë për 30 vjet.
- Referuar parashikimeve të Kontratës Shtesë të nënshkruar me MIE-n nr. 1537 rep., nr. 518 kol., datë 23.06.2021, ku përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 90 ditëve nga data e pajisjes me lejet e nevojshme për fillimin e punimeve të ndërtimit e të vërë në punë Centralin Fotovoltaike brenda 9 muajve nga data e marrjes së

- të gjitha lejeve për fillimin e punimeve. Shoqëria ka informuar, me shkresën e datës 05.12.2024 se ka respektuar afatet e kontratës së nënshkruar me MIE-n dhe të lejes së ndërtimit (deri më 15.12.2024). Aktualisht, punimet ndodhen në një fazë të përparuar dhe parashikohet që ato të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Në këto rrethana, vlerësohet që t'i lihet kusht asaj që, përpara fillimit të operimit, të dokumentojë në ERE testimin e veprës, në përputhje me përcaktimet e nenit 10, të kontratës nr. 9112 rep., nr., 3449 kol., datë 29.12.2017, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 1 975 kW, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau Dejës, për një afat 30-vjeçar.
2. Përpara fillimit të operimit, shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në kuadër të plotësimit të pikës 2.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë “FTL” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI